

With funding from



THIRRJE PËR APLIKIM NË KUADËR TË FONDIT TË GRAVE TË KOSOVËS

Publikuar më: 20 janar 2023

Afati i fundit për aplikim: 20 shkurt 2023

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kënaqësinë të publikojë raundin e 18 të granteve në kuadër të Fondit të Grave të Kosovës (FGK). Ftojme organizatat tona anëtare të aplikojnë me projekte të cilat do të **kontribuojnë në avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave dhe barazisë gjinore në Kosovë.**

Më konkretisht, **aplikacionet** duhet të demonstrojnë se si organizatat propozojnë të kontribuojnë në realizimin e Strategjisë dhe objektivave të saj të identifikuar nga anëtarët e RrGK-së, në kuadër të Strategjisë së RrGK-së për periudhën 2023-2026, duke avokuar për **përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave**, të cilat promovojnë të drejtat e njeriut dhe synojnë të sjellin ndryshime afatgjata.

RrGK inkurajon fuqishëm të ndërmirren iniciativa avokuese në nivel lokal dhe qëndror. Avokimi mund të përfshijë takime me zyrtarë të institucioneve, ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, hulumtim të politikave, propozime për ndryshimin e politikave dhe inkurajimin e qytetarëve për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Këto iniciativa duhet të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të rëndësishme (p.sh., legjislacion i ri, shërbime të reja, raporte mbi rastet e dhunës me bazë gjinore, raste të monitoruara në gjykata, etj.). Ju lutemi keni parasysh që aktivitetet e ndërmarra nuk konsiderohen si rezultate të arritura të projektit.

Llojet e aktiviteteve që do të merren parasysh për përkrahje financiare përfshijnë: organizimin e takimeve me gra dhe persona në pozita vendimmarrëse, organizimin e fushatave për vetëdijesim dhe avokim, ngritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave që të avokojnë për prioritetet e tyre, përkrahja e grave dhe vajzave në takime me politik-bërës për të influencuar ndryshime në ligjet ekzistuese dhe rregulloret që kanë të bëjnë me shqetësimet e tyre, hulumtime të orientuara drejt politikave, hulumtime të orientuara drejt avokimit, marrëdhëniet me publikun mbi çështjet avokuese, rrjetëzimin/shkëmbimin e përvojave me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave dhe avancimin e të drejtave të tyre si e drejtë e njeriut, trajnime, tryeza të rrumbullakëta/diskutime dhe strategji të tjera avokuese.

Llojet e aktiviteteve që nuk do të merren parasysh përfshijnë: aktivitetet që lidhen pjesërisht ose plotësisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca dhe kongrese; veprimet që lidhen pjesërisht ose plotësisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi; blerja e patundshmërive; blerja e automjeteve; blerja e pajisjeve (përveç nëse është e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit); veprimet që përkrahin partitë, grupet dhe lëvizjet politike.

Zbatuar nga:



Më tej, në pajtueshmëri me Strategjinë e RrGK për vitet 2023-2026, llojet e iniciativave të cilave do t'u jepet prioritet për financim do të përfshijnë:

Avancimi i barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit

- Përfshirja e grave në avokim për të pasur qasje në kujdes më të mirë shëndetësor, si dhe marrjen e masave për të kërkuar kujdes shëndetësor cilësor, ofrimi i kushteve të volitshme për të pasur një sigurim shëndetësor, dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të grave në kujdesin shëndetësor cilësor;
- Bashkëpunimi i grave për t'i vetëdijesuar gratë dhe vajzat për të drejtat e tyre në kujdesin shëndetësor (sidomos për shëndetin riprodhues dhe shëndetin e nënave) dhe bashkëpunimi i tyre për t'i raportuar abuzimet në mënyrë zyrtare tek autoritetet përkatëse;
- Konsultimi i raportit hulumtues të RrGK-së, [Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë](#) dhe të dhënave të tjera në dispozicion mbi qasjen e grave në kujdes cilësor shëndetësor në mënyrë që të përdoret për të kontribuar në avokim dhe ngritjen e vetëdijes.

Transformimi i normave gjinore përmes edukimit

- Avokimi në nivel lokal dhe qendror për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për nevojën e më shumë qendrave parashkollore dhe qendrave të kujdesit për fëmijë;
- Avokimi për përmirësimin e edukimit seksual në shkolla, dhe/ose në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Monitorimi i institucioneve parashkollore dhe qendrave të kujdesit ditor lidhur me cilësinë e arsimit të ofruar në përputhje me legjislacionin e arsimit parashkollor, si dhe avokimi i përfshirjes së mësimdhënies drejt transformimit të normave tradicionale gjinore;
- Bashkëpunimi me MASHTI për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulave në shkolla në nivel tjetër nga një perspektivë gjinore drejt transformimit të normave gjinore.

NDARJA E GRANTEVE MADHËSIA, LLOJET DHE KOHËZGJATJA E GRANTEVE

Financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me bashkëfinancim nga nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) përmes nismës Avancimi i iniciativës për të drejtat e grave II", RrGK parasheh të ndaj 15 grante në vlerë 5.000 euro për grant. Shuma totale që pritet të shpërndahet është 75,000€.

Projektet pritet të fillojnë rreth 1 qershor 2023 dhe mund të zgjasin maksimalisht deri në gjashtë (6) muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës. RrGK rezervon të drejtën të financojë disa apo asnjë nga aplikacionet e paraqitura, si dhe të diskutojë me organizatat aplikuese alokimin e aktiviteteve sipas nevojës duke mos dalur jashtë kategorive të lartpërmendura. Vendimi final do të mirret nga Komisioni për Vlerësimin e Granteve (KVG) i FGK-së.

Të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në këtë thirrje për propozime inkurajohen të marrin pjesë në punëtoritë orientuese të organizuara nga RrGK përpara se të dorëzojnë aplikacionet e tyre:

-Punëtorja për aplikacionet lidhur me të drejtën e grave për kujdes shëndetësor në kuadër të fushës programatike Avancimi i barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit do të mbahet me **7 shkurt 2023**.

-Punëtorja për aplikacionet në fushën Transformimi i normave gjinore përmes edukimit do të mbahet me **10 shkurt 2023**.

KUSHTET E PËRZGJEDHJES

Organizatave që aplikojnë duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

1. Të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete në përputhje me strategjinë e tyre organizative;
2. Të ndërmarrin aktivitete që kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë së RrGK-së 2023-2026, që përfshinë programet në vazhdim:
 - o Avancimi i barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit
 - o Transformimi i normave gjinore përmes edukimit
3. Të sigurojnë 10% të kostos totale të projektit nga ndonjë donator tjetër apo vetëkontribut (p.sh. punën vullnetare të dokumentuar). Shuma e 10% duhet të pasqyrohet në buxhetin e propozuar;
4. Nuk duhet të ketë anëtare të stafit që janë aktualisht pjesë e bordit të RrGK, ose pjesë e KVG-së.

KVG do t'ju japë prioritet për financim:

- Iniciativave avokuese për të sjellë ndryshime afatgjata në përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel lokal dhe/ose qendror;
- Iniciativave që kanë për qëllim të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të rëndësishme (p.sh., legjislacion i ri, shërbime të reja të nevojshme, raporte mbi rastet e dhunës me bazë gjinore, raste të monitoruara në gjykata, kurrikula gjinore-transformuese, politika të mira ndaj familjes në ndërmarrjet private etj.);
- Iniciativa që angazhojnë persona me aftësi të ndryshme; grupet etnike të minoriteteve; dhe grupet e marginalizuara;
- Organizatave të cilave ju mungojnë mundësi tjera të sigurimit të fondeve nga donatorë të ndryshëm.

PROCEDURAT E APLIKIMIT

RrGK do të pranojë aplikacione të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Aplikimet mund të dorëzohen në e-mail adresën: grants@womensnetwork.org. Aplikuesit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. Aplikacionin, duke përdorur formën e aplikimit të RrGK-së (në formatin Word, e bashkangjitur dhe në dispozicion në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2023/02/FGK_Forma-e-aplikimit-1-1.docx) ; dhe
2. Propozimin e buxheti, duke përdorur formën e RrGK-së (në formatin Excel, të bashkangjitur dhe në dispozicion në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2023/01/FGK_Forma-per-Buxhet-Propozim.xlsx);

Ju lutemi vini re: të gjitha buxhetet duhet të paraqesin ndarje të shpenzimeve (që do të thotë bashkë-financim nga një tjetër institucion) dhe/ose kontribut jo-financiar (që nënkupton punë vullnetare, kontribute të dhuruara nga bizneset, përfshirja e komunitetit) në vlerë prej 10% të buxhetit të përgjithshëm që është propozuar. Kjo duhet të ceket në buxhetin e propozuar. FGK mund të konsiderojë mbulimin e pagave dhe shpenzimet operative por vetëm në rastet kur aplikuesi të ketë bërë një spjegim të qartë se si mbulimi i tillë do t'ju mundësojë atyre avancimin e të drejtave të grave dhe/ose barazinë gjinore.

Propozimet e paraqitura RrGK-së duhet të jenë punë origjinale që i përkasin vetëm organizatës aplikuese. Plagjiatura do të rezultojë në diskualifikimin nga procesi i vlerësimit të mëtutjeshëm.

RrGK do të mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikantët. RrGK nuk do të përdorë informacionin e paraqitur nga aplikantët për qëllime të tjera, përveç shqyrtimit dhe nuk do të ofrojë këtë informacion për persona të tjerë apo institucione, përveç kur kërkohet nga ligjet e Kosovës ose nga donatorët.

Pas dorëzimit të aplikacioneve, organizatat aplikuese do të marrin një letër konfirmimi të pranimit me një numër të aplikimit, të nënshkruar nga stafi i RrGK-së.

AFATET KOHORE

Aktiviteti	Data
Publikim i thirrjes për aplikim	20 janar 2023
Punëtorja për aplikacionet në fushën Avancimi i barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit	7 shkurt 2023
Punëtorja për aplikacionet në fushën Transformimi i normave gjinore përmes edukimit	10 shkurt 2023
Afati i fundit për aplikim	20 shkurt 2023
Data kur pritët publikimi i aplikacioneve të përzgjedhura	Java e fundit të majit 2023
Sesioni Orientues, nënshkrimi i kontratave, dhe data kur pritët fillimi i projekteve	1 qershor 2023

KONTAKTET PËR INFORMATA

Kërkesat për sqarime / informata shtesë: Organizatat aplikuese duhet të dorëzojnë kërkesat e tyre për sqarim përmes e-mailit në grants@womensnetwork.org më së largu deri më **16 shkurt 2023 në ora 17:00**.